



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me Nr.03/L-040, nenin 53, nenin 54, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative me datën merr:

V E N D I M

1. Anulohen konkursat e shpallura për mësimdhënës për moszbatim të Ligjit për Zyrtaret Publik dhe Rregullores (QRK) Nr:19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve Dhe Sekretarëve Në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore Dhe Aftësuese (IEAA) Të Arsimit Parauniversitar.

Arsyetim

Komuna e Obiliqit ka shpalluar konkurse për mësimdhënës dhe pas shqyrtimit të procedurës së rekrutimit konstatohet se konkursat anulohen në bazë të nenit 10 pika 1.3 dhe 2.5 të Rregullores (QRK) Nr:19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve Dhe Sekretarëve Në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore Dhe Aftësuese (IEAA) Të Arsimit Parauniversitar. Konkursat që anulohen janë:

1. Mesues Klase në SHFMU "Migjeni" në Siboc me RN00018762
2. Mesues Klase në SHFMU "Fazli Grajqevci" në Lajthishtë me RN00018797
3. Mesues Klase në SHFMU "Hasan Prishtina" në Millosheve (zv.p.lehonise) me RN00018933
4. Bazat e Elektronikes në SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq me RN00018847
5. Edukatorët në Kopshtet e Fëmijëve në Mazgit dhe Millosheve me RN00018763
6. Gjuhe Angleze në SHFMU "Hasan Prishtina" në Millosheve (zv.p.lehonise) me RN00018951
7. Edukatë Qytetare në SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq (zv.p.lehonise) me RN00018934

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë ankese në Inspektoratin e Punës në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të vendimit në sistemin e SIMBNJ dhe në ëeb-faqen zyrtare të Komunës.

